



Projekti është i financuar nga
Bashkimi Evropian



"Barazia Gjinore Në Mjediset Rurale"

(Buxheti i projektit € 72, 600.00 /EU Contract € 67, 947.00 / Kohezshtjete: 12 muaj)

Projekti është zbatuar nga Shoqata për zhvillim lokal rural, financuar nga Bashkimi Evropian, përmes Instrumentit Evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut (EIDHR Country Based Support Scheme). Aktivitetet e projektit filluan në janar 2012, në komunat e Bogovinës, Bërvenicës, Vrapçishtit dhe Zhelinës.

Ky projekt synon të arrijë një zhvillim shoqëror efektiv dhe të drejtë, si dhe të rrisë barazinë gjinore në komunitetet rurale, përmes institucionalizimit të një qasjeje për integrim gjinor në procesin e hartimit të politikave në nivel lokal.

Grupet e interesit:

Anëtarët e Komisioneve për Barazi Gjinore të Komunave të Bogovinës, Bërvenicës, Tearcës, Zhelinës dhe Vrapçishtit.

Përfituesit nga projekti:

Pjesëtarët e gjinisë femërore nga komuna e Bogovinës, Tearcës, Vrapçishtit, Zhelinës dhe Bërvenicës; Organizatat e shoqërisë civile; Personeli i Njësive të Vetëqeverisjes Lokale

Synimet e veçanta:

- Zhvillimi i kapaciteteve për integrim gjinor efektiv të institucioneve lokale, komisioneve për barazi gjinore dhe OJQ-ve;
- Krijimi i mekanizmave dhe metodologjive efektive për integrim gjinor – Plan Lokal për Barazi Gjinore – për lehtësimin e procesit të integritit gjinor në nivel lokal;
- Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë për çështjet e integritit gjinor përmes informimit gjithëpërfshirës dhe fushatës mediale.

Detyrat e projektit

- Formimi i rrjetit për hartim të planit lokal për barazi gjinore;
- Mbështetja dhe stimulimi i pjesëmarrjes ndërmjet partnerëve;
- Ndërtimi i kapaciteteve të anëtarëve të Komisioneve për Barazi Gjinore dhe grupeve të interesuara;
- Hartimi dhe miratimi i Planeve për Barazi Gjinore si vegla efektive për inkuadrim gjinor në nivel lokal;
- Zbatimi i fushatës senzibilizuese për barazi gjinore (organizimi i debateve publike, aktiviteteve mediale, përgatitja e materialeve edukative).

Rezultatet e pritura

- **Vendosja e mekanizmave për pjesëmarrje** të sektorit civil në krijimin dhe zbatimin e politikave lokale për barazi gjinore;
- **Vendosja e bashkëpunimit efektiv** për integrim gjinor ndërmjet të gjithë partnerëve relevant në nivel lokal;
- **Vendosja e veglave dhe metodologjive efektive** për integrim gjinor në pesë komunat e fushës së Pollogut;
- **Ngritja e vetëdijes** së përgjithshme në rajonet rurale në lidhje me konceptet "barazia gjinore" dhe "fuqizimi i gruas" si dhe dobitë prej tyre.